



KQZ trajnon Personat me Aftesi te Kufizuar

Për herë të parë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, do të angazhojë si specialistë pranë Zyrate Rajonale Zgjedhore, 12 Persona me Aftësi të Kufizuara, të cilët i trajnoi sot në ambientet e KQZ-së. Në fjalën e saj përshëndetëse, Kryetarja e KQZ-së, znj. Luzi tha se, KQZ ka vendosur të çojë në një nivel tjetër bashkëpunimin me Personat PAK, dhe angazhimi i tyre në 12 Zyrat Rajonale Zgjedhore, në 12 qarqet e vendit e tregon këtë më së miri.

“Ju nuk jeni vetëm votues por edhe pjesëmarrës aktiv në procesin zgjedhor. Angazhimi juaj në Zyrat Rajonale Zgjedhore do të shërbejë si një urë lidhëse mes KQZ-së dhe zgjedhësve PAK, në mënyrë që e çdo problematikë që do të evdientohet, të bëhen përpjekjet maksimale për t’i dhënë zgjidhje para datës 21 Qershor. KQZ ka bashkëpunuar me ju edhe në zgjedhjet e kaluara dhe do të vazhdojë të bashkëpunojë ngushtë me ju për zgjedhjet e 21 qershorit 2015”, tha znj. Luzi.

Kryetarja e KQZ-së, Zëvendëskryetari dhe Anëtarët, gjatë bashkëbisedimit me përfaqësuesit e Personave me Aftësi të Kufizuar, ndër të tjera kanë siguruar se KQZ po punon intensivisht, që të bëhet e mundur prodhimi i shabllonëve që ndihmon zgjedhësit që nuk shikojnë për të votuar në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Nga ana e tyre 12 personat PAK, shprehën vlerësimet e tyre pozitive për mundësinë që Komisioni Qendror i zgjedhjeve ju ka dhënë, duke i punësuar por edhe duke i përfshirë në mënyrë aktive në procesin zgjedhor. Ata dëshmuan para Komisionerëve, përgjegjësinë maksimale për realizimin me sukses të detyrës së ngarkuar nga KQZ.

Personat e angazhuar në Zyrat Rajonale Zgjedhore do të kenë detyrë të ndjekin në

dinamikë problematikat e zgjedhësve PAK dhe evidentimin e tyre në kohë, me qëllim marrjen e mënjëhershme të masave për zgjidhjen e saj, në Qendrat e Votimit dhe Zonat e Adminsitrimin Zgjedhor të qarkut përkatës.

Periudha e angazhimit të tyre, do të jetë dy muaj para ditës së zgjedhjeve, deri në ditën e zgjedhjeve.

Pas trajnimit të zhvilluar nga Administrata e KQZ-së, të 12 personat që do të angazhohen në ZRZ, kanë nënshkruar kontratat e punësimit me KQZ-në.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin edhe përfaqësues të partive politike, përfaqësues të Prezencës së OSBE-së dhe organizatave të tjera që operojnë në fushën e zgjedhjeve.